# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-454677**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Presidenti Begaj dekreton ligjin për formulën e re të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve! |
| ADRESA | `https://prapaskena.com/2026/09/18/presidenti-begaj-dekreton-ligjin-per-formulen-e-re-te-pagave-te-gjyqtareve-dhe-prokuroreve/` |
| BURIMI | prapaskena.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 10:27:12 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 17 shtator 2026, 22:00:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën* ***text_date****. Dritarja: 17 shtator 2026, 21:59:00 UTC → 17 shtator 2026, 22:01:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `5d08f861a3d7fb21b733729b6f47f50f5ec3a84ff4fd8156fe14322d8a63c61e` |
| TEKSTI | `ef646ed386c342507afec097c5674ec7e225a7601f46124f7d4a21ad2f49525c` |
| PAMJA | `5b68bbd98f49e3f7a6e34f0b45d3aaa09d3d26b7652ba9ace20fa90602479ff1` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `d54f197792bf00a4c6bd8be2534e5a22b416c93e0753a29f90a86c6c30523069` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `5f16ab6556ceb0058bf60cb7198a73729e9daa0d09a0a505b3785d533f275135` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/d54f197792bf00a4c6bd8be2534e5a22b416c93e0753a29f90a86c6c30523069`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Presidenti Begaj dekreton ligjin për formulën e re të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve!

Politikë

Publikuar: 18/09/2026



Vetëm pak orë pasi mazhoranca e PS votoi me 84 vota projektligjin për formulën e pagave të gjyqtarëve e prokurorëve, Presidenti i Republikës, Bajram Begaj, ka nxjerrë sot dekretin për shpalljen e ligjit nr. 95/2026, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, ‘Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’”, duke i hapur rrugë hyrjes së tij të menjëhershme në fuqi.

Më herët, Kreu i Shtetit kishte dhënë pëlqimin për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit, pas kërkesës së Kuvendit, i cili e kishte argumentuar urgjencën me bllokimin e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Sipas argumentimit të Kuvendit, shfuqizimi i dispozitave për pagat e magjistratëve nga një vendim i Gjykatës Kushtetuese kishte bërë që pagesat për gjyqtarët dhe prokurorët të mos mund të kryheshin që prej 1 gushtit 2026.

Pa hyrjen në fuqi të ndryshimeve të reja ligjore, Thesari i Shtetit nuk mund të procedonte me çlirimin e pagave për magjistratët.

Qëllimi i ligjit të ri është zhbllokimi i pagesave për gjyqtarët dhe prokurorët, përfshirë pagat e prapambetura nga 1 gushti 2026 dhe pagesat në vijim.

Sipas argumentimit zyrtar, hyrja në fuqi e ligjit përmes procedurës së zakonshme do ta vononte procesin me rreth 15 deri në 35 ditë. Për këtë arsye, Presidenti dha pëlqimin për hyrjen e tij të menjëhershme në fuqi.

## Me të lexuarat


Kush është Behajdin Allaqi, njeriu që Haga vendosi në qendër të dënimit të Thaçit dhe pikëpyetjet...


Çoi padashje një video pornografike në një bisedë me shoqet, si u zbulua abuzimi i 12-vjeçares


Fuqizoi Millosheviçin me naftë/ Shehu kërkon llogari për gjenocidin serb, Haga rikthen akuzat e...


Botoxi kontrabandë fryhet për “Gremi Wellness” dhe shfryhet për “Keit”, si u mbyll dosja për dokt...


Skandali në tenderin e KQZ: Si ndërhyri Sekretarja në sistem për favorizuar kompaninë e vëllain e...

Në qëndrimin e tij, Presidenti thekson se argumentet dhe kundërargumentet kushtetuese që lidhen me masën e pagave mund të diskutohen edhe në instanca të tjera kompetente. Megjithatë, sipas tij, zhbllokimi ligjor i pagesave mund të bëhet vetëm përmes hyrjes në fuqi të ligjit të ri.

Presidenti e konsideron vendimin për hyrjen e menjëhershme në fuqi të ligjit si një masë që i përgjigjet një nevoje urgjente dhe që lidhet drejtpërdrejt me parimin e pavarësisë së gjyqësorit.

Sipas Presidencës, garantimi i standardit të jetesës dhe qëndrueshmërisë së të ardhurave për gjyqtarët dhe prokurorët është pjesë e rëndësishme e garantimit të pavarësisë së magjistratëve.

Me dekretimin e ligjit, pritet të vijojë procedura për zhbllokimin e pagave të magjistratëve, të cilat kanë qenë të bllokuara që prej 1 gushtit.

TAG: Bajram begaj

## Të ngjashme



**“A t’u martua daja?”/ Gallatë në orët e vona në Kuvend, Zegjine Caushi përplaset me Bardhin: Shiko hallin tënd, Gazo!**



**Sali Berisha pranon se ka paguar para për të marrë një vizë amerikane, ja kush loboi**

**Gogu: Rishikim i KPP-së për masat e sigurimit; rekomandimet e Këshillit të Evropës po kthehen në reformë**


## Prapaskena

‘Prapaskena’ lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. ‘Prapaskena’ është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.’

## Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.



## Kategoritë

KREU INVESTIGIM KRIM & KORRUPSION DOSJE ROZË KRYESORE POLITIKË EKONOMI ANALIZË RAJON KULTURË SPORT



Email: [email protected]

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

Privacy Policy | Cookies

Notice: ob_end_flush(): Failed to send buffer of zlib output compression (1) in /home/prapaskena/public_html/wp-includes/functions.php on line 5581 Notice: ob_end_flush(): Failed to send buffer of zlib output compression (1) in /home/prapaskena/public_html/wp-includes/functions.php on line 5581 Notice: ob_end_flush(): Failed to send buffer of zlib output compression (1) in /home/prapaskena/public_html/wp-includes/functions.php on line 5581 Notice: ob_end_flush(): Failed to send buffer of zlib output compression (1) in /home/prapaskena/public_html/wp-includes/functions.php on line 5581

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.